



DURRËS

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



gadc@gadc.org.al



+355 4 22 555 14



www.popalbania.info



+355 68 20 59 301



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamez, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje të shumë të nevojshme të ofertave të partitë politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.

ORGANIZATAT

- | | |
|--|--|
| • Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë | • Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër |
| • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës | • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë |
| • Qendra Rinore Vlorë | • Qendra Rinore për Progres, Kukës |
| • ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë | • Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec |
| • Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz | • Lëvizja "Mjaft" |
| • Epoka e Re, Fier | |

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Në Bashkinë e Durrësit u zhvilluan në muajin mars 2019, 6 Forume me banorë të lagjeve të qytetit të Durrësit, Katundit të Ri, Manzës, Rrashbullit dhe Sukthit. Forumet kishin si qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetet lokale, si dhe identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej 6 Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Në forume pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

Pjesëmarrja sipas gjinive

Burra 28 %

Gra 72 %



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensioni social




Demokracia vendore

Për secilën prej 26 çështjeve objekt diskutimi qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi prioritetet që në këndvështrimin e tyre duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në tre grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;
3. **Vijueshmëri**, përfshin çështje të cilat kanë arritur zhvillimin e pritshëm nga komuniteti dhe për to nevojitet vetëm ruajtje e të njëjtit standart nga të zgjedhurit vendorë.



30 janë prioritetet e komunitetit të prezantuara gjerësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë që i ka dhënë vetë komuniteti, për të cilat do të lobohet për të qenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendor, sikurse përmbushja e të cilave do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

● Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE ●

Janë **14 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR  • Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave • Nxitja e punësimit	SHËRBIMET PUBLIKE  • Gjellbërimi • Kanalet kulluese/vaditëse • Infrastruktura, rrugë dhe trotuare • Pastrimi • Shkollat • Transporti publik • Furnizimi me ujë dhe kanalizimet • Kopshte dhe çerdhe
DIMENSIONI SOCIAL  • Programe dhe shërbime të kujdesit shoqëror për individët në nevojë • Pjesëmarrja e grave në vendimarrje • Programe dhe shërbime të bashkës mbi a dresimin e dhunës në familje	DEMOKRACIA VENDORE  • Transparenca në vendimarrje

18 prioritetet e komunitetit janë shprehje e nevojës për të zhvilluar më tej çfarë është arritur deri tani në secilën prej çështjeve të diskutuara dhe për të përmbushur më mirë në vijim nevojat e komuniteteve lokale.

● Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE ●

Janë **11 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR  • Incentivat për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës • Niveli i taksave dhe tarifave në raport me shërbimin • Shërbim këshillimi për bujqësinë • Programe për mbështetjen e fermerëve • Pagesa e taksave nga qytetarët • Njoftimi i qytetarëve mbi detyrimin për taksat/tarifat	SHËRBIMET PUBLIKE  • Ndiçimi • Pyjet dhe kullotat
DIMENSIONI SOCIAL  • Romët dhe egjiptianët	DEMOKRACIA VENDORE  • Informimi dhe komunikimi • Pjesëmarrja në vendimarrje

Janë 12 prioritete të formuluar nga komuniteti që, sikurse edhe në prioritetet e grupit të parë, janë një kërkesë e tij për të zhvilluar më tej angazhimet e Bashkisë për përmbushjen e nevojave të komunitetit.

● Grupi i tretë/ NDËRHYRJE VIJUESE ●

Shërbimi veterinar është çështja që ka marrë vlerësimin maksimal në të gjitha forumet ku është diskutuar. Për këtë çështje koeficienti i prioritetit të përcaktuar nga komuniteti ishte 3 (aspak prioritare).

Për shërbimin veterinar u diskutua në forumet e Manzës, Katundit të Ri, Rrashbullit dhe Sukthit. E përbashkëta e forumeve është fakti që pjesëmarrësit ishin të kënaqur me shërbimin veterinar dhe kërkuan vijueshmërinë e këtij shërbimi me të njëjtën cilësi. Kjo është arsyeja pse për këtë çështje nuk u formulua prioritet specifik në ndjekje.

● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

NXITJA E BIZNESEVE TË TË RINJVE DHE GRAVE

Pjesëmarrësit në Forume janë të informuar për faktin që Plani Lokal i Përfshirjes Sociale 2017-2019 ka përcaktuar si një nga prioritetet lokale nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave, megjithatë atë theksojnë se në praktikë Bashkia duhet ta ketë më shumë në fokus këtë çështje. "Ka plane, kemi degjuar, por janë shumë sporadike. Vetëm punësimi i 4 ose 5 të rinjve me aftësi të kufizuar të punësuar nuk është i mjaftueshëm për tu quajtur arritje për nxitjen e punësimit të tyre".¹

Prioritet 1: Zhvillim i mëtjeshëm i programeve egzistuese për nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave.

NXITJA E PUNËSIMIT

"E konsiderojmë shumë prioritare punën që duhet të bëjë Bashkia për nxitjen e punësimit." Në Forume banorët shprehën nevojën për të patur më shumë informacion nga Bashkia mbi përpjekjet që bëjnë për të nxitur punësimin, ndërkohë që theksojnë se gratë kryefamiljare, familjet në vështirësi ekonomike dhe të rinjtë si ata të ardhur rishtazi në Durrës, ashtu edhe nga banorët egzistues duhet të konsiderohen si grupe prioritare për punësim.

Prioritet 2: Informim i vazhdueshëm i publikut mbi programet që zhvillon e zbaton Bashkia për nxitjen e punësimit

Prioritet 3: Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të prioritojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës:

- Gratë kryefamiljare
- Pjesëtarë madhorë të familjeve me ndihmë ekonomike
- Të rinjtë



● SHËRBIMET PUBLIKE ●

GJELBËRIMI

Gjelbërimi, ambjentet çlodhëse për të moshuarit dhe ambjentet e lojës për fëmijët u cilësuan shumë prioritare nga pjesëmarrësit në Forume. *"Është çështje shumë prioritare, pasi sipërfaqet e gjelbërta po na i ha betoni dhe mirë kemi ndërtime, por të paktën të planifikohen me një gjelbërim përreth"*. Për fëmijët dhe të moshuarit, problematika më e madhe është mos pasja e hapësirave të gjelbërta dhe argëtuese, shlodhëse për ta. Mungesa e parqeve për fëmijët i detyron prindërit t'i çojnë fëmijët në qendra tregtare të qytetit për t'i argëtuar.

Prioritet 4. Zgjerim i hapësirave të gjelbërta në qytet.

Prioritet 5. Ngritja e parqeve publike që plotësojnë nevojat e fëmijëve dhe të moshuarve.

KANALET KULLUESE/VADITËSE

Në të gjitha forumet e zhvilluara në Manëz, Katund të Ri, Rrashbull dhe Sukth u theksua se cilësia e kanaleve kulluese dhe vaditëse lë shumë për të dëshiruar. Kanalet kulluese në përgjithësi nuk janë funksionale duke shkaktuar kështu edhe përmbajtje të herë pas herëshme. Në Manëz, një nga zonat me sipërfaqen më të lartë të administrimit të tokës bujqësore (53,5%) u theksua jo vetëm mos pastrimi i kanaleve egzistuese të kullimit, por edhe mungesa e kanaleve të kullimit në fshatra. Kanali në fshatin Shkallë, u theksua, nuk është pastruar prej 20 vitesh. Ky kanal zgjatet deri në hidrovor dhe më pas derdhet në det dhe pastrimi i tij do të ishte shpëtim për një zonë shumë të madhe, u shprehën pjesëmarrësit në Forum.

Në Katund të Ri dhe Rrashbull jo vetëm u theksua mos funksionimi i kanaleve, por edhe fakti që pastrimi që bëjnë vetë banorët nuk arrin të zgjidhi problemin. *"Kanalet kulluese kanë më shumë se 5 vjet që nuk i është venë dorë dhe këtu flasim për kanalet kulluese parësore, pasi ato dytësoret janë në gjendje të mjeruar. Ato pastrohen nga vetë personat që i kanë afër, por kur nuk ke shërbimin, ç'ti pastrosh vetë? Ato që pastron të kthehen mbrapa"* - u shprehën pjesëmarrësit në Forum në Sukth.

Prioritet 6. Ndërhyrje e menjëherëshme dhe e vazhduar në kanalet kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative Manëz, Katund i Ri, Rrashbull dhe Sukth.

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

Në të gjitha Forumet e zhvilluara u theksua nevoja për ndërhyrje në rrugët egzistuese. Në forumet e lagjeve të Durrësit u konsiderua prioritare ndërhyrja në rrugët në periferi, kryesisht zonën e Spitalit të Durrësit. U theksua gjithashtu shqetësimi që në rrugët egzistuese shpesh bëhen ndërhyrje nga kompani të ndryshme, rrugët hapen dhe në përfundim të ndërhyrjeve të tyre ato nuk risistemohen tërësisht. Gjerësia dhe përshtatshmëria e trotuareve gjithashtu përbën shqetësim. *"Nga një anë gjysmën e trotuarit e zë hapësira e pemës, nga ana tjetër trotuaret nuk janë të lehta për t'u përdorur nga personat me aftësi të kufizuara"* - u shprehën banorët. Probleme me sinjalistikën rrugore theksuan banorët e lagjes 14 (lagje në kryqëzim të Urës së Dajlanit dhe zonës për në stacion të trenit), ku ka mungesë semaforësh dhe vijash të bardha. Me prioritet gjithashtu u theksua vendosja e sinjalistikës përpara shinave të trenit në zonën që lidh hyrjen e Portit të Durrësit me zonën Industriale të Shkzetit.

Në Manëz u theksua nevoja për rregullimin e dy rrugëve në fshatin Kamerras, të rrugëve Beqallarët, Rrugës së Varrezave, sistemimi i Kucokut me rrugë dhe hapësira të gjelbërta, rrugës së Borçës e cila është me çakull, kur në fakt duhet të jetë me asfalt sipas standardeve.

"Janë bërë investime në rrugët parësore që lidhin qendrën e njësisë administrative me shumë zona të tjera, por rrugët dytësore bujqësore janë më kryesoret për ne" - theksuan pjesëmarrësit në Forumin e Katundit të Ri. Rikonstruksioni i rrugëve bujqësore shihet si domosdoshmëri për zhvillimin e bujqësinë. Në Rrashbull ka nevojë për ndërhyrje në rrugicat e Shën Vlashit dhe janë gjithashtu prioritare rrugët që të çojnë në pikat turistike si një mundësi për të afuar turistët. Në Sukth pjesëmarrësit në Forum theksuan nevojën për ndërhyrje si në rrugët kryesore, ashtu edhe në rrugët dytësore që i lidhin me tokën bujqësore.

Prioritet 7. Vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për secilën prej njësive vijuese:

Lagjet e qytetit të Durrësit. Ndërhyrje në rrugët në periferi, kryesisht zonën e Spitalit të Durrësit; Risistemim i rrugëve pas ndërhyrjeve që kryejnë kompanitë për zhvillimin e bizneseve të tyre. Në planifikim dhe investime të mirë-vlerësohet gjerësia dhe përshtatshmëria e trotuareve sipas nevojave të këmbësorëve në përgjithësi dhe personave me aftësi të kufizuara në veçanti. Vendosje e sinjalistikës rrugore në lagjen 14 (lagje në kryqëzim të Urës së Dajlanit dhe zonës

● SHËRBIMET PUBLIKE

për në stacion të trenit), si dhe përpara shinave të trenit në zonën që lidh hyrjen e Portit të Durrësit me zonën Industriale të Shkozetit.

Manëz. *Rregullimi i dy rrugëve në fshatin Kamerras, të rrugëve Beqallarët, Rrugës së Varrezave, sistemimi i Kucokut me rrugë dhe hapësira të gjelbërta, rrugës së Borcës.*

Katund i Ri. *Investime në rrugët dytësore bujqësore. Rrashbull.* *Ndërhyrje në rrugicat e ShënVlashit dhe investime prioritare në rrugët që të çojnë në pikat turistike.*

Sukth. *Investime si në rrugët kryesore, ashtu edhe në rrugët dytësore që i lidhin me tokën bujqësore.*

PASTRIMI

Në thelb qyteti i Durrësit pastrohet çdo ditë, theksuan pjesëmarrësit në Forumet e lagjeve të Durrësit, por ka nevojë për të shtuar numrin e koshave për mbetjet urbane. Koshat egzistues janë të vjetër, me rrota të prishura dhe pa kapak. Ndërhyrje e menjëherëshme kërkohet në zonën arkeologjike dhe muzeale të Bashkisë Durrës që ka vetëm 3 kosha për një zonë me mbi 500 banorë.

Në forumin e Manzës u theksua se pastrimi bëhet nga vetë banorët. Mbeturinat lihen në rrugët kryesore, makina e pastrimit merr ato që janë në rrugën kryesore dhe jo në të gjitha rrugët. Mungesa e koshave për grumbullimin e mbetjeve u theksua edhe në Katundin e Ri. Mungesa e tyre nxiti banorët që t'i hedhin mbetjet në lumë për rrjedhojë shpesh përjetojnë përmbytjen e lumit Erzen dhe dëmtim të tokave bujqësore. *"Makina për mbledhjen e mbetjeve vjen vetëm dy herë në javë"- theksuan pjesëmarrësit në Forumin e Rrashbullit. "Jemi pranë sezonit veror dhe semundjet do të shtohen edhe më shumë me ngrohjen e motit nëse pastrimi nuk bëhet në mënyrë të rregullt".*

Numri i vogël i koshave të mbetjeve dhe distanca e madhe e atyre që janë na vendbanimet u theksua në forumin e Sukthit. Të dyja këto ndikojnë që banorët ti hedhin mbetjet vend e pa vend apo ti derdhen në kanale që më pas nuk pastrohen.

Prioritet 8. Shtim i koshave për mbledhjen e mbetjeve urbane në lagjet e qytetit të Durrësit.

Prioritet 9. Shtim i koshave për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga makina e mbledhjes së mbeturinave të paktën 1 herë në dy ditë në Manëz, Rrashbull, Sukth dhe Katund të Ri.

SHKOLLAT

Pjesëmarrësit në forumet e lagjeve të Durrësit dhe në Manëz vlerësuan ndërhyrjet e përvitëshme që ka kryer Bashkia për reabilitimin e shkollave si në qendër edhe në zonat periferike, megjithatë ka nevoja të vazhdueshme për infrastrukturë brenda shkollave egzistuese. Këto përfshijnë kryesisht sisteme ngrohje, terrene sportive dhe laboratorë të informatikës.

Në forumet e Sukthit dhe Rrashbullit u theksua se shkollat egzistuese janë të amortizuara dhe kanë nevojë për ndërhyrje të menjëherëshme. *"Shkollës ku ne jemi mbledhur sot nuk i është venë dorë këtu e 50 vjet. Është shkollë e vjetër, të themi që në kohën e komunizmit dhe kësaj shkolle po i bien themelet, sistemi i ndriçimit është copë-copë, na fiken dritat sa ndezim një dritë edhe pse transformatorin e energjisë e kemi në fushën mbrapa shkollës, sistemi elektrik digjet çdo dy muaj".*

Përveç infrastrukturës së papërshtatëshme të shkollave, pjesëmarrësit në forumin e Katundit të Ri theksuan edhe mungesën e personelit ndihmës në shkolle, kryesisht personel për pastrimin, ruajtjen e shkollës, sikurse dhe mungesën e psikologut. Shkollat nuk janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Prioritet 10. Përmirësime në shkollat egzistuese në secilën prej njësive vijuese:

Durrës dhe Manëz. *Përmirësim i infrastrukturës në shkollat egzistuese, ku përfshihen sisteme ngrohje, terrene sportive dhe laboratorë të informatikës.*

Sukthi dhe Rrashbulli. *Rikonstruksion i plotë dhe emergjent i shkollave egzistuese.*

Katundi i Ri. *Rikonstruksion, si dhe plotësim i strukturës me personel për pastrimin, ruajtjen e shkollës dhe psikolog.*

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

TRANSPORTI PUBLIK

Mungesa e transportit të qëndrueshëm dhe me orare të caktuara u konsiderua një problem nga pjesëmarrësit e forumit në Manëz e që kërkon një zgjidhje. *"Linjat urbane që lidhin Katundin e Ri me Durrësin janë problematike për shkak të mos korrektesës në orare dhe kushteve jo të mira sanitare-higjenike"*- theksuan pjesëmarrësit në forumin e Katundit të Ri.

Shumë prej banorëve të kësaj njësie administrative i drejtohen Bashkisë për të marrë shërbime, ndërkohë që mungesa e shpeshësisë në orare të autobuzëve krijon humbje kohe të panevojshme për ta. Tjetër problem është edhe kufizimi i orareve të autobuzëve deri në orën 17.00. Banorët shpesh detyrohen të përdorin taksi që krijon kosto për ta. Banorët kërkojnë që përveç shtimit të linjave duhet të merret parasysh edhe ulja e çmimit të biletës së transportit, pasi është shumë e kushtueshme për familjet të cilat janë edhe me ndihmë ekonomike. Në Forumet e Rrashbullit dhe Sukthit prioritar për zgjidhje u konsiderua çështja e transportit të fëmijëve për në shkollë për shkak të distancës së largët nga vendbanimi.

Prioritet 11. Përmirësim i cilësisë së transportit publik sipas njësive vijuese:

Manëz. Përcaktimi dhe publikimi i orareve të transportit publik dhe rritja e kohëzgjatjes së këtij transporti.

Katund i Ri. Korrektesë në oraret e mbërritjes në stacion, përmirësim i kushteve higjeno-sanitare, rritja e shpeshësisë së autobuzëve dhe e kohëzgjatjes së këtij shërbimi edhe pas orës 17.00.

Rrashbull dhe Sukth. Të zgjidhet çështja e transportit të fëmijëve për në shkollë për shkak të distancës së largët nga vendbanimi.

FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET

Rregullimi i infrastrukturës së ujërave të bardha dhe atyre të zeza në lagjet e qytetit të Durrësit është një tjetër prioritet i dalë nga forumet e zhvilluara në këtë territor. *"Shumë nga lagjet në qytetin e Durrësit mbeten pa ujë për shkak të ndërhyrjeve në rrjetin e ujësjellës kanalizimeve dhe uji që ata marrin në shtëpi është jashtë kushteve dhe standarteve të ujit për konsum"*- u shprehën pjesëmarrësit në forum. Në Manëz pjesëmarrësit në forum theksuan se furnizimi me ujë të pijshëm është i kufizuar në kohë, një herë në 48 orë dhe koha e furnizimit është vetëm 20 min në ditë.

Ndërkohë ka familje që nuk furnizohen me ujë pasi nuk janë të lidhura me tubacionin e ujit. Në Njësinë Administrative Manëz, Fshati Manëz, mungon personeli për

monitorimin e furnizimit me ujë të pijshëm të këtij fshati dhe fshatrave përreth. Aktualisht janë 5 depozita uji pa roje. Në njësinë administrative Rrashbull fashtarat Vrin dhe Shenvlash kanë 20 vjet pa ujë të pijshëm, ndërsa nuk ka probleme në fshatrat e tjerë. Kufizimet në ujin e pijshëm u prezantuan si shqetësim për banorët e njësive administrative në Sukth, ndërkohë që forumi në Katundin e Ri nuk evidentoi probleme me ujin e pijshëm pasi banorët përdorin pusët.

Prioritet 12. Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njësive vijuese:

Lagjet e qytetit të Durrësit. Rregullimi i infrastrukturës së ujërave të bardha dhe atyre të zeza.

Manëz. Furnizimi me ujë i familjeve që aktualisht nuk janë të lidhura me rrjetin e ujësjellës. Shmangia e kufizimeve në furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve. Vendosi e personelit që monitoron 5 depozitat që furnizojnë me ujë të pijshëm fshatrat e kësaj njësie.

Rrashbull. Furnizimi me ujë të pijshëm i fshatrave Vrin dhe Shenvlash.

Sukth. Eliminimi i kufizimeve në furnizimin me ujin e pijshëm.

KOPSHTË DHE ÇERDHE

Në të gjitha Forumet e zhvilluara u theksua nevoja për përmirësime në infrastrukturën e kopshteve dhe çerdheve. Sa më shumë i largohemi qendrës së Bashkisë aq më shumë shtohet nevoja për përmirësimin e kushteve. *"Në qendër janë mirë, por në zonat periferike janë pa kushte, pa ngrohje, detyrohen prindërit të sponsorizojnë për kushte më të mira për fëmijët e tyre"*.

Në Forumet e njësive administrative Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull pjesëmarrësit vlerësuan se kopshtet dhe çerdhet janë jashtë funksionit. *"Kopshtet private po na mbysin me tarifat e larta, kopshte shtetërore nuk kemi dhe ato që kemi janë larg ose në kushte të papërshtatshme"*. Situata e kopshteve nuk u raportua problematike në njësinë administrative Manëz.

Prioritet 13. Rikonstruksion i kopshteve dhe çerdheve egzistuese në lagjet periferike të qytetit Durrës, në Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

DIMENSIONI SOCIAL

PROGRAME DHE SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR PËR INDIVIDËT NË NEVOJË

Nevoja për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Durrës u shpreh qartë në të gjitha Forumet e organizuara. Njësitë administrative Manëz, Katund i Ri, Rashbull dhe Sukth përgjithësisht ishin në dijeni që ka shërbime të ngritura, por nga të cilat përfitojnë individë në nevojë që jetojnë në lagjet e qytetit Durrës. Ata theksuan nevojën për të ngritur shërbime edhe në territorin e njësive të tyre administrative. Edhe në forumet e organizuara në lagjet e qytetit Durrës u vlerësua si prioritet ngritja e shërbimeve të reja, pasi, siç u shprehën pjesëmarrësit, Bashkia Durrës ka numër të lartë popullsie dhe shërbimet aktuale janë të pamjaftueshme.

Prioritet 14. Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë në lagjet e qytetit Durrës, si dhe ngritja e shërbimeve të reja sipas nevojave të vlerësuara në njësitë administrative Manëz, Sukth, Katund i Ri dhe Rashbull.

PJESËMARRJA E GRAVE NË VENDIMARRJE

Pjesëmarrësit në Forumet e njësive Manëz, Katund i Ri, Rashbull dhe Sukth shprehen se janë të pa informuar mbi nivelin e përfaqësimit të grave në vendimarrjet në Bashki, si në këshillin bashkiak, ashtu edhe në administratën e Bashkisë. Në këndvështrimin e tyre kjo ndodh edhe sepse asnjë këshilltar/e nuk është përfshirë me këto komunitete për t'i dëgjuar apo konsultuar. Ata shprehen në favor të përfaqësimit të grave në strukturat vendimarrëse. Pjesëmarrësit në Forumet e lagjeve të Durrësit janë të informuar mbi përfaqësimin e grave në këshillin Bashkiak, mendojnë që është në nivelin e duhur. Sygjerojnë rritjen e numrit të grave në administratën e Bashkisë.

Prioritet 15. Rritja e përfaqësimit të grave të zonave rurale në Këshillin Bashkiak dhe zhvillimi i programeve që nxisin komunikimin e të zgjedhurve vendor me komunitetet lokale.

PROGRAME DHE SHËRBIME TË BASHKISË MBI ADRESIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Diskutimet në lidhje me programet dhe shërbimet e Bashkisë për adresimin e dhunës në familje në forumet e zhvilluara treguan se informimi i komuniteteve për këtë çështje në zona të ndryshme të Bashkisë është i ndryshëm.

Në forumet e lagjeve të Durrësit, Katundit të Ri dhe Rashbullit pjesëmarrësit ishin në dijeni si të programeve ashtu dhe shërbimeve të Bashkisë. Në forumet e Manëzës dhe Sukthit pjesëmarrësit ishin të pa informuar mbi përpjekjet e Bashkisë për adresimin e dhunës. Gjithsesi edhe atje ku komuniteti është i informuar, u theksua nevoja e zbatimit të plotë të programeve.

"Po ka programe të veçanta për mbrojtjen nga dhuna, kjo është e përfshirë edhe në planin lokal social të Bashkisë, por për tu diskutuar është fakti i zbatueshmërisë së këtij programi ⁵."

Prioritet 16. Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj.

Prioritet 17. Zgjerim i shërbimeve egzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruuese për viktimat e dhunës në familje.

DEMOKRACIA VENDORE

TRANSPARENCA NË VENDIMARRJE

Në të gjitha forumet konsiderohet prioritare bërja transparent e vendimeve që merr Bashkia. Edhe pse Bashkia ka një faqe në internet kjo faqe përditësohet rrallë, ndërkohë që në këtë faqe qytetarët nuk gjejnë informacion të nevojshëm për ta dhe detyrohen të shkojnë deri në Bashki për të marrë informacionin që u nevojitet. Në njësitë administrative Manëz dhe Sukth pjesëmarrësit në Forume u shprehën se nuk ka as kënd për shpalljen e vendimeve apo njoftimeve publike.

Prioritet 18. Zhvillimi i mekanizmave që mbajnë në konsideratë mundësitë e komuniteteve për ta marrë informacion dhe që mundësojnë transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak

SHËRBIMET PUBLIKE

NDRIÇIMI

Shqetësim për pjesëmarrësit në Forume përbën ndriçimi në zonat larg qendrës së qytetit. *"Nëse do të duam një qytet me standarte duhet të kemi në radhë të parë ndriçimin. Kemi qendrën të bukur, por duhet parë përtej qendrës në zonat ku vërtet ka nevojë".* Në shumë nga lagjet e Durrësit, mund të ekzistojnë si shtylla, por nuk janë funksionale dhe kjo ka shkaktuar shpeshherë edhe vjedhje në zonë apo edhe rrahje, dhunë apo grabitje. Me prioritet kërkohet përmirësimi i ndriçimit në zonat ku ka përqendrim të fabrikave të fasonerisë, pasi gratë e vajzat nisen për në punë që në 6 të mëngjesit dhe e lenë punën në 5 të pasdites. Veçanërisht gjatë dimrit mungesa e ndriçimit rrit pasigurinë e tyre. Në njësitë administrative Manëz, Rrashbull, Sukth dhe Katund i Ri është i nevojshëm përmirësim i ndriçimit paralelisht me zhvillimin e infrastrukturës rrugore.

Prioritet 19. Përmirësim i ndriçimit në zonat periferike të qytetit, njësitë administrative, si dhe me prioritet në zonat ku ka përqendrim të fabrikave të fasonerisë.

PYJET DHE KULLOTAT

Në Forumet e Manzës, Katundit të Ri, Rrashbullit dhe Sukthit diskutimi u fokusua tek drutë e zjarrit. Banorët i blejnë drutë për t'i përdorur për ngrohje dhe vlerësojnë se çmimi i tyre është i lartë.

"Duhet ulur përdorimi i drurëve dhe të gjenden alternativa të tjera për ngrohje si në sistemin e shtëpive, ashtu edhe në institucione".

Në forumin e njësisë administrative Rrashbull në lidhje me kullotat u theksua se qiratë e tokës apo kullotës që merren për shfrytëzim janë të larta dhe të papërbalueshme për t'u shlyer, ndërsa në Sukth u theksua mungesa e kullotave.

Prioritet 20. Në konsultim me komunitetin e njësisë administrative Bashkia të identifikoj zgjidhje për problematikën e kullotave.



DEMOKRACIA VENDORE

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Bashkia ka të ndërtuar një sistem për ta bërë informacionin dhe shërbimet të aksesueshme për qytetarët. Zyra e informacionit të Bashkisë asiston qytetarët në këtë proces. Pjesëmarrësit në forumet e Manzës, Katundit të Ri, Rrashbullit dhe Sukthit shprehën shqetësimin që jo çdo informacion mund ta marrin pranë njësive administrative ku banojnë. Kjo sjell humbje kohe, por edhe krijon kosto për banorët që duhet të udhëtojnë deri në zyrat e Bashkisë. *"I marrim informacionet, por do ishte mirë që këto informacione të na bëhen të ditura nga njësia herë pas here, sepse shkojmë dhe herë marrim përgjigje herë jo"*.

Pjesëmarrësit në Forumin e Rrashbullit u shprehën se: *"I marrim kur kemi pasur nevojë për informacion, por edhe detyrohemi të lëvizim nga Njësia, sepse jo të gjitha na ofrohen atje si përpara Reformës Territoriale, ku gjithë shërbimi merrej në zonë. Na duhet një ditë e tërë mos thënë 2 që të marrim një shkresë nga Bashkia e Durrësit, shpenzime kohe dhe financiare."* - Kur na duhet një informacion shkojmë e marrim në njësinë administrative, por shpesh na thonë nuk e kemi në kompetencë, drejtoheni Bashkisë së madhe. Kur shkojmë të marrim përgjigje atje thonë riktheheni në njësinë tuaj pasi ata e kanë kompetencë. Jemi bere si top futbollit, por edhe që të shkojme deri në Durrës për një letër, kjo ka kosto kohe dhe financiare. Mirë një qytetar që ja ka mundësinë po një që është i pamundur fizikisht?" - u shprehën pjesëmarrësit në Forumin e Sukthit.

Një tjetër problematikë e identifikuar në forumin e lagjeve të qytetit Durrës lidhet me personat me aftësi të kufizuara që sipas tyre janë të limituar nga marrja e informacionit.

Prioritet 21. Çdo informacion i nevojshëm për qytetarët të ofrohet në sportelet e njësive administrative, për të shmangur humbjen e kohës së tyre, si dhe kostot e transportit.

Prioritet 22. Çdo informacion të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

Nga diskutimet mbi këtë çështje në forumet e zhvilluara konkludojmë se Bashkia Durrës ndërmerr procese konsultimi me komunitetin për vendimarrjet më të rëndësishme, porse mekanizmi që përdor për të nxitur pjesëmarrjen e komunitetit në to nuk është jo vetëm i unifikuar, por as edhe tërësisht efektiv. Në forumet e lagjeve të qytetit të Durrësit pjesëmarrësit u shprehën se Bashkia duhet të ketë këndin e njoftimeve në çdo njësi apo rajon në të gjithë territorin e Bashkisë. *"Kemi marrë pjesë në konsultime në rastet që jemi njoftuar, por shpesh herë informacioni rrjedh pa u marrë vesh që do ketë konsultim nga bashkia dhe merret shumë muaj më vonë ose fare ky informacion"* - u shprehën ata.

Në Manëz jo të gjithë kryepleqtë njoftohen e marrin pjesë në procese konsultimi dhe shqetësimi i shprehur ishte mungesa e një lidhje organike konstante mes Bashkisë dhe njësive administrative.

Në Rrashbull mekanizmi i informimit për proceset konsultuese funksionon, por pjesëmarrësit u shprehën gjithashtu se *"Kush e sheh të arsyeshme për të marr pjesë shkon dhe diskuton, po sesa merren në konsideratë mendimet tona kjo është diçka tjetër. Transparenca duhet të jetë e para për qytetarin"*.

Ndërkohë në Sukth edhe pse janë bërë takime konsultuese pjesëmarrësit u shprehën se *"ne i kemi marrë vesh me vonesë, dhe jo çdokush e di që nesër p.sh diskutohet për një çështje që e prek edhe qytetarin në mënyrë të drejtpërdrejtë"*.

Prioritet 23. Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

- mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit,
- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin,
- mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese.

ZHVILLIMI EKONOMIK

INCENTIVAT PËR NXITJEN E BIZNESIT DHE KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS

Edhe pse nuk ndiheshin shumë të informuar për këtë çështje pjesëmarrësit në Forumet e lagjeve të qytetit Durrës u shprehën se Bashkia zbaton incentiva për nxitjen e biznesit, porse ajo duhet të bëjë më shumë. Ata i vlerësojnë përpjekjet e Bashkisë në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës "deri diku mirë, por jo në nivelin që duhet të jetë një bashki e rendit të parë, pasi ne vijmë të 2-tët pas bashkisë së Tiranës për pjesën e bizneseve të ngritura dhe kemi një zonë industriale shumë funksionale të populluar nga biznese vendase dhe të huaja."

Prioritet 24. Zhvillimi më tej nga Bashkia Durrës i incentivave që nxisin biznesin e për pasojë krijojnë vende të reja pune.

NIVELI I TAKSAVE/ TARIFAVE NË RAPORT ME SHËRBIMIN

Pjesëmarrësit në forumet e lagjeve të qytetit të Durrësit e shohin cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Bashkia të lidhur me nivelin e mbledhjes së taksave. "Shërbimet varen nga taksat që mbledhim, nëse nuk mbledhen s'mund të pretendohet për një shërbim të mirë apo shërbim ekzistues". Në Manëz sygjerman rishikim të taksave për tokën bujqësore. "Kanë pasur mundësi ta ulin taksën për banorët, por nuk është bërë asgjë për uljen e tyre. Ka taksa të larta për bujqësinë"- u shprehën ata.

Prioritet 25. Rivlerësim i nivelit të taksave për tokën bujqësore në konsultim me komunitetin.

Prioritet 26: Krijimi i lehtësive në nivelin e taksave/tarifave për kategoritë në nevojë.

PROGRAME PËR MBËSHTETJEN E FERMERËVE

Kjo çështje u diskutua në forumet e Manzës, Katundit të Ri, Rrashbullit dhe Sukthit. E përbashkëta e forumeve është fakti që pjesëmarrësit janë në dijeni të egzistencës së programeve për mbështetjen e fermerëve. Në Katundin e Ri pjesëmarrësit vlerësuan faktin që nuk kërkohet dokumentacion që në fillim të aplikimit, gjë që shmang kostot e panevojshme. Megjithatë ata u shprehën se "Ka programe, por nuk ka fituar askush nga zona jonë, pasi ka kritere të larta të përfitimit". Pjesëmarrësit në forumin e Rrashbullit konsideruan problematik faktin që përfitimi nga këto programe është i kushtëzuar me hapësirën e tokës apo të krerëve të bagëtisë, gjë që përforcon konkluzionin e Katundit të Ri për kriteret e larta të përfitimit.

Prioritet 27. Zbutje e kriterëve të përfshirjes në programet e mbështetjes së fermerëve.

NJOFTIMI I QYTETARËVE MBI DETYRIMIN PËR TAKSAT/TARIFAT DHE PAGESA

Në të gjitha forumet e zhvilluara u theksua se qytetarët marrin njoftim në shtëpi mbi detyrimin për taksat/tarifat. Gjithsesi theksuan se nuk ishin të informuar se sa dhe si mbledheshin taksat. Në Forumet e lagjeve të qytetit Durrës u theksua se "ka nevojë për rregullime të mëtejshme në mënyrën e mbledhjes së taksave nga Bashkia". Në forumin e njësisë administrative Manëz pjesëmarrësit u shprehën se "Nuk paguhen taksat e pastrimit, ndriçimit etj, pasi banorët nuk kanë mundësi të shkojnë deri në Durrës ndërkohë që nuk kanë një pikë grumbullimi në zonën e tyre."

Prioritet 28. Krijimi i kushteve për kryerjen e pagesave të taksave/tarifave sa më pranë vendbanimit të qytetarëve.

Prioritet 29. Informim i komunitetit nga strukturat e Bashkisë mbi nivelin e mbledhjes së taksave dhe rishpërndarjen e tyre përmes buxhetit vjetor.

DIMENSIONI SOCIAL

ROMËT DHE EGJIPTIANËT

Në forumet e zhvilluara ku përfshihen zona që kanë komunitet rom dhe egjiptian, pjesëmarrësit ishin në dijeni të egzistencës së planit specifik të Bashkisë për këtë komunitet dhe të faktit që Bashkia ofron shërbime specifike për ta. Megjithatë atë vlerësuan se angazhimi i Bashkisë për riintegrimin dhe fuqizimin e këtij komuniteti duhet të vazhdojë.

Prioritet 30. Trajtim më prioritet i programeve që nxisin riintegrimin dhe fuqizimin e komunitetit rom.